



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Komuna Rahovec - Opštine Orahovac

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë - Sektori për pronë
Odeljenje za Katastar, Geodeziju i Imovinu - Sektor za imovinu

Data - Datum	26.08.2019
Referencë/a	08 nr. 31/2019
Për/Za/To :	Sahit Asllan Kryeziu nga Xërxa
Zona Kadastrale:	Xërxë
Përmes/ Prekp/Through:	Afrim Oruqi - Drejtor Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë
Nga/Od/From/	Sektori për pronë
Subjekt/Subekat/Subject:	Vendim

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë - Sektori për pronë K.K. Rahovec duke vendosur sipas kërkesës së Drejtorisë për Punë Inspektuese – Inspektori i Ndërtimtarisë 14 nr. 2291 datë 25.007.2019, me të cilën është kërkuar që të zhvillohet procedura e uzurpimit arbitrar në pronësinë shtetërore, kundër të dyshuarit Sahit Asllan Kryeziu nga Xërxa, në bazë të nenit 16, 17 dhe 18 të Ligjit Mbi Shqyrtimin e Marrëdhënieve Pasurore të krijuar me uzurpim arbitrar të tokës në pronësinë shtetërore (“ Gazeta zyrtare e KASK ”, nr. 46/77 dhe 37/88), dhe nenit 21 të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 05/L-031, merr:

V E N D I M

I. VERTETOHET Se Sahit Asllan Kryeziu nga Xërxa me ndërtimin e murit rrethues me material të fortë ndërtimor (beton të armuar) dhe material tjetër përcjellës ka bërë zgjerimin e parcelës së vetë nr. 1807-0 në dëm të parcelës shtetërore nr. 1523-1, duke bërë uzurpim arbitrar në sipërfaqe të përgjithshme 204 m² parcela shtetërore evidentohet në emër të P.sh.e. Kosov. – Rrugë.

II. Uzurpuesi arbitrar Sahit Asllan Kryeziu nga Xërxa, është i obliguar që pjesën e parcelës së uzurpuara ta liroj me mënjanimin e murit rrethues të cekura në pikën I, dhe të njëjtën ta kthej në gjendjen e mëparshme, në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij vendim.

III. Nëse i përmenduri në afatin e caktuar ligjor nuk e liron sipërfaqen e uzurpuar, vendimi do të ekzekutohet në mënyrë të dhunshme.

IV. Uzurpimi është kryer në vitet e fundit.

V. Shpenzimet e procedurës bien në barrë të uzurpuesit arbitrar.

A r s y e t i m

Inspektori i ndërtimtarisë me kërkesën 2291 më datë 25.07.2019 ka njoftuar këtë drejtori se gjatë mbikëqyrjes së rregullt inspektuese mbi ndërtimin e objekteve pa leje në Komunën e Rahovecit përkatësisht në fshatin Xërxë ka hasur tek Sahit Kryeziu ndërtimin e murit rrethues të cekura në pikën I të këtij vendimi, për çka dyshohet se këto ndërtime janë bërë në parcelën komunale nr. 1523-1 dhe ka kërkuar nga kjo drejtori të vërtetohet në vendin e ngjarjes.

Drejtorja për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë – Sektori për Pronë i K.K. Rahovec së bashku me gjeodetin e kësaj drejtorie kanë dal në vendin e ngjarjes dhe pas matjes dhe incizimit së parcelës komunale nr. 1523-1 ka konstatuar se i përmenduri me veprimet që ka ndërmarr ka bërë uzurpim arbitrar në parcelën komunale në të cilën eksperti i gjeodezisë ka hartuar skicën e terrenit me të cilën shihet qartë pozita, kufiri dhe sipërfaqja e uzurpuar.

I përmenduri gjatë kryerjes së matjes dhe incizimit në vend është marr në pyetje ku ka deklaruar se: Murin rrethues e kam ndërtuar me bindjen se pjesa e parcelës 1523-2 është pronë e imja dhe se gjatë gjithë kohës këtë pjesë të parcelës e kemi shfrytëzuar pa pengesë nga askushi. Unë mendoj se është bërë gabim gjatë aëroingjizimit të parë të vitit 1959 dhe se kjo parcelë është regjistruar gabimisht në emër të K.K. Rahovec – Rrugë.

Kjo drejtori ka analizuar dhe vlerësuar faktet dhe në fund ka vendosur në këtë çështje administrative, pasi që gjatë matjes dhe incizimit të parcelës në fjalë të pasqyruar në skicën e terrenit, është vërtetuar se i përmenduri, ka bërë uzurpim arbitrar.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, në bazë të nenit 16, 17 dhe 18 të Ligjit mbi shqyrtim e marrëdhënieve pasurore të krijuar me uzurpim të tokës në pronësi shtetërore ("Gazeta Zyrtare e KASK", 46/77 dhe 37/88), është vërtetuar se i përmenduri ka bërë uzurpim arbitrar në parcelën komunale, të cekur në dispozitë të këtij vendimi.

U vendos pranë Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë – Sektori i Pronës K.K. Rahovec, më datë 26.08.2019

08 nr. 31/2019

KESHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi mund të parashtrohet ankesë në Agjencinë Kadastra të Kosovës, Prishtinë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit nëpërmjet kësaj drejtorie.

Hartuesi

Jur. i Diplomuar. Nazmi Krasniqi



Drejtori

Jur. Diplomuar. Afrim Oruqi

